



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar më datë **29.04.2021** Nr. Regj.Them. **12/44/151**, ka paraqitur pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar kërkesën penale me objekt: **Konfiskimin e pasurive** në pronësi të Subjektit **Aurel (alias Altin) Hoxhallari** dhe personave të lidhur me të.
2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Etleva Deda, bazuar në nenet bazuar në nenet 16, 23 e 24 të aktit normativ nr. 1, datë 31.01.2020 “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit të sigurisë publike”, me vendimin Nr. **12**, datë 10.07.2024, vendosi:
 - **Konfiskimin e pasurive të sekuestruara me Vendimin nr. 156, datë 30.11.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si më poshtë:**
 1. Pasuria objekt me sipërfaqe 30 m², me adresë: rruga “*Aleksandri i Madh*”, Yzberisht, Unaza e Re, Njësia Administrative Kashar, Tiranë, pjesë e objektit 1 (një) katësh për të cilin kanë aplikuar për t’a legalizuar shtetasit **Aurel Hoxhallari** dhe **Elton Hoxhallari**, me nr. Prot. *** e vitit 2009.
 2. Pasuria objekt me sipërfaqe 20 m², me adresë: rruga “*Teodor Keko*”, Unaza e Re, Tiranë, pjesë e objektit 1 (një) katësh për të cilin kanë aplikuar për t’a legalizuar shtetasit **Aurel Hoxhallari** dhe **Elton Hoxhallari**, me nr. Prot. *** e vitit 2009 (shoqëruar me fotografitë përkatëse).
 3. Pasuria me nr. ***, datë 21.04.2016, në emër të shtetasës **Kimete Hoxhallari** (lidhur me banesën 3 (tre) katëshe në Yzberisht).
 4. Pasurinë në proces legalizimi me nr. ***, datë 27.01.2015, në emër të shtetasit **Nezhdet Hoxhallari** (lidhur me banesën dhe magazinën në Kodër – Mëzez).
 - **Kalimin në favor të shtetit të pasurive të konfiskuara.**

- **Revokimin/heqjen e masës së sekuestros së vendosur me Vendimin nr. 156, datë 30.11.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbi pasuritë:**
 1. Pasuria me nr. ***, zona kadastrale ***, volumi **, faqe **, lloji i pasurisë “Arë”, me sipërfaqe totale 300 m², e ndodhur në Yzberisht, në pronësi të shtetasit **Aurel Hoxhallari**. Kjo pasuri është blerë sipas kontratës së shitjes me nr. *** Rep. dhe *** Kol., datë 24.07.2007.
 2. Pasuria me nr. ***, zona kadastrale ***, volumi **, faqe ***, lloji i pasurisë “Arë”, me sipërfaqe totale 400 m², e ndodhur në Yzberisht, në pronësi të shtetasit Aurel Hoxhallari, referuar kontratës së shitblerjes nr. *** Rep. dhe nr. *** Kol., datë 04.07.2007, Numri i pasurisë është ***, në përputhje edhe me volumin dhe faqe është i njëjtë.
 3. Pasuria me nr. ***, zona kadastrale ***, volumi **, faqe ***, lloji i pasurisë “Arë”, me sipërfaqe totale 210 m², e ndodhur në Yzberisht, në pronësi të shtetasit **Aurel Hoxhallari**.
 4. Pasuria e llojit “*Apartament*” me nr. pasurie ***, volumi **, faqe **, me sipërfaqe 61.2 m², me adresë: rruga “*Muhamet Gjollesha*”, pallati nr. 7, shk. 1, kati 3, apartamenti 5, Tiranë, në pronësi të shtetasës **Dhorothea Male**, e vërtetuar kjo nëpërmjet Kontratës me nr. *** Rep. dhe nr. *** Kol., datë 23.04.2014.
- Konform nenit 31 paragrafi 4, 5, 6 të ligjit nr. 34/2019 “*Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara*” ndryshuar me ligjin nr. 19/2019 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara”*”, shpenzimet gjyqësore dhe të administrimit të pasurive të sekuestruara, i ngarkohen subjektit të aktit normativ.
- Për administrimin e pasurive të konfiskuara ngarkohet Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara.
- Një kopje e këtij vendimi, pasi të marrë formë të prerë, t’i dërgohet brenda 24 orëve Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda 15 ditëve nga marrja dijani apo njoftimi i vendimit.

Tiranë më datë 10.07.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar